

Nr. Prot. 032/B/18

VENDIM Nr. 1196

Për

Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik të

“Planit për Hapjen e Brezeve”

Në mbështetje të nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.6), nenit 10, paragrafi 4) dhe 12), nenit 45 paragrafët 1) dhe paragrafi 2), nenit 54 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 4), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar |
| 2) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar |
| 5) z. Shqiprim Pula | Anëtar |

në mbledhjen e 28-të me radhë të mbajtur më datë 18 Maj, 2018 pas shqyrtimit të Rekomandimit të Grupit Punues sipas Vendimit Nr.1130 (*Ref. Nr.Prot.405/2/18*), vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i konsultimit publik të dokumentit: **“Plani për Hapjen e Brezeve”**, i cili i është bashkangjitur këtij vendimi.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **23 Maj 2018** dhe përfundon më datë **06 Korrik 2018**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10 paragrafi 12 (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizon kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 45, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se: “Spektri frekuencor (kanalet) do të menaxhohet duke u bazuar në Planin Kombëtar të Radio – frekuencave dhe Planin për përdorimin e radio – frekuencave (kanaleve) konform planeve zhvillimore për radio komunikime.”

Neni 54, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se ARKEP vendos kushtet për shfrytëzimin e radio-frekuencave.

Ekspertët e angazhuar nga BERZH, në kuadër të projektit për ngritjen e kapaciteteve për ARKEP, kanë përgaditur një raport me rekomandimet përkatëse lidhur me çështjen e hapjes së brezeve frekuencore me rëndësi të posaçme ekonomike si dhe kanë dhënë rekomandime për hapat e mëtutjeshme. Grupi Punues, i përbërë nga ekspertët e ARKEP, i themeluar me Vendimin nr. 1130, pa analizimit të këtij Raporti ka hartuar dokumentin “Plani për hapjen e brezeve”.

Draft dokumenti “Plani për Hapjen e Brezeve” përshkruan në mënyrë të detajuar Kornizën rregullatore në Republikën e Kosovës dhe Bashkimin Evropian (BE) lidhur me brezet frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT, kapacitetet e frekuencore të disponueshme në Republikën e Kosovës për secilin brez, pasqyrën e tregut të komunikimeve elektronike me fokus në tregun e telefonisë mobile, si dhe janë parashtruar një numër i konsiderueshëm i pyetjeve për palët e interesit ashtu që procesi të administrohet sa më mirë.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t’i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Prandaj, në përmbushje të objektivave të përcaktuara në:

- Ligjin Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike, i cili rregullon aktivitetet e komunikimeve elektronike, përfshirë këtu menaxhimin e resurseve frekuencore bazuar në neutralitetin teknologjik dhe Kornizën Rregullatore të BE-së,
- Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike “Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020” për zhvillimin e rrjetëve të komunikimeve elektronike brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës,

Si dhe marrë parasyshë Rekomandimin e dhënë nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) për hapjen e brezeve frekuencore për zhvillimin e mëtutjeshëm të rrjetave dhe shërbimeve, atëherë Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 23/05/2018

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
- Komisionit të Pavarur për Media,
- Ndërmarrjeve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike
- Arkivës së Autoritetit.